



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Produktuar Received/Delivered	20.11.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinita Org./Unit	In Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHCE	7038/2023		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1251/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1251/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesi më adresë fshati Koretin, Komuna e Kamenicës, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1251/2023 e datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së ankuesit në pajtim me Vendimin me Nr.058 të datës 17.01.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, sipas kërkesës për pagesë retroaktive të datës 07.02.2023.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 15.07.2020 në pozitën Oficer Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan në kuadër të



Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 15.12.2022 ka parashtruar kërkesë për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes nënës, ndërsa sipas Vendimit me Nr. 058 të datës 17.01.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të njëjtit i është lejuar pagesa e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 07.02.2023 ka procedurë në Thesarin e Kosovës formularin për pagesën e një page me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes për ankuesin, mirëpo nga ana e Thesarit të Kosovës nuk është bërë zbatimi i vendimit të datës 17.01.2023.

Ankuesi lidhur me moszbatimin e Vendimit me Nr. 058 të datës 17.01.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 04.10.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 05.10.2023 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1251/2023 me numër protokoll 6399/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 09.10.2023 ka përcjellë kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 10.10.2023 ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 6399/2023 të datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 18.09.2023 nga për Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 07.02.2023; Ankesën e datës 06.09.2023; Vendimin me Nr. 058 të datës 17.01.2023; Zarin e datës 04.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 10.10.2023; Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 15.07.2020; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile e datës 22.12.2022; Dokument identifikues i ankuesit; Kërkesën e datës 15.12.2023; Deklaratën për bashkësinë familjare e datës 22.12.2022; Certifikatë e vdekjes e datës 22.12.2022; Ankesë e datës 06.09.2023; Kërkesën e datës 08.11.2023 drejtuar për zyrtarin e Thesarit të Kosovës nga Vërtetimin me numër 15 të datës 15.11.2023 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit Lokal në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Kamenicës; Emailin e datës 07.02.2023 nga për dhe Shkresën për pagesat e pagave me ndryshim për muajin shkurt 2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për zv. Udhëheqësin e Divizionit të Sistemit të Pagesave në Ministrinë e Financave; Konfirmimin për disponueshmërinë e mjeteve buxhetore e datës 01.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar më datë 05.10.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është zbatuar Vendimi me Nr. 058 i datës 17.01.2023 i zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.



Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se përmes Certifikatës së Vdekjes me Nr. serik V 10557127 të datës 22.12.2022, konstatohet se gjegjësisht nëna e ankuesit ka ndërruar jetë me datë 10.12.2022, ndërsa ankuesi kërkesën për kompensim të një page me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes e ka parashtruar më datë 15.12.2022, ndërsa vendimi për lejimin e pagës shtesë është nxjerr më datë 17.01.2023 nga zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në kohën kur ankuesi ka parashtruar kërkesë po ashtu edhe në kohën kur është nxjerr vendimi për kompensim ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji lidhur me kompensimet tjera respektivisht Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, si rezultat i kësaj, edhe me rastin e kompensimit të një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil për ankuesin me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (nënës), aplikohen dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën kur edhe kërkohet kompensimi.

Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të aplikueshme në kohën e vdekjes së nënës së ankuesit, përkatësisht Kolegji i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku me nenin 22 paragrafi 2 përcaktohej se: *2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; ..2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil; si dhe dispozitave të nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ku parashihej se: ...2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzonte të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.*

Sa i përket çështjes së përmbajtjes së kush bënë pjesë në familjen e ngushtë, Kolegji ju referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: *"Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji".* Lidhur me këtë fakt, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Nisur nga përcaktimi ligjor si më sipër, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatës së Vdekjes me Nr. serik V 10557127 të datës 22.12.2022, konstatohet se gjegjësisht nëna e ankuesit ka ndërruar jetë me datë 10.12.2022, kurse sipas Vërtetimit me numër 15 të datës 15.11.2023 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit Lokal në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshëm në Komunën e Kamenicës, është vërtetuar se ankuesi ka jetuar me nënën e tij deri në momentin e vdekjes e të ndjerës me datë 10.12.2022, kështu që, duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimi



ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së nënës është i bazuar.

Meqenëse Shërbimi Korrektues i Kosovës, respektivisht zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes Vendimit me Nr. 058 të datës 17.01.2023 i ka lejuar kompensimin shtesë për rastin e vdekjes së anëtarit të familjes dhe duke marr parasysh faktin që kërkesa për pagesë retroaktive e datës 07.02.2023 është dërguar për ekzekutim në Thesarin e Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit në kuptim të respektimit të normave ligjore të cekura si më lartë konstaton se Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përmbushur obligimin ndaj ankuesit, ngase Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes shkresave të lëndës, më datë 07.02.2023 rastin e kompensimit të ankuesit e ka përcjellë në Thesarin e Kosovës përkatësisht tek z. për pagesat e pagave me ndryshime për muajin Shkurt 2023, ndërsa përmes emailit të njëjtën e ka përcjellë tek znj. dhe z. ndërsa tani çështja e ekzekutimit të vendimit Nr. 058 të datës 17.01.2023 për pagesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes të ankuesit bie në barrë të Thesarit të Kosovës, kështu që sipas këtij vendimi obligohet Drejtori i Thesarit të Kosovës që në kuptim të Vendimit me Nr.058 të datës 17.01.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, sipas kërkesës për pagesë retroaktive të datës 07.02.2023 dhe legjislacionit të aplikueshëm në kohë, të bëjë zbatimin e këtij vendimi si në dispozitiv të tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1251/2023, datë 17/11/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.